

VENDIM
Nr. 302, datë 23.5.2018

**PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 78, DATË 28.1.2015, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR ZBATIMIN E LIGJIT NR. 150/2014, “PËR PENSIONET E
PUNONJËSVE QË KANË PUNUAR
NË MINIERA, NË NËNTOKË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 10, të ligjit nr. 150/2014, “Për pensionet e punonjësve që kanë punuar në miniera, në nëntokë”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas shkronjës “i”, të pikës 1, të kreut I, të vendimit nr. 78, datë 28.1.2015, të Këshillit të Ministrave, shtohet paragrafi “i/1”, me këtë përmbajtje:

“i/1) do të konsiderohet periudhë sigurimi, për efekt përfitimi, sipas ligjit nr. 150/2014, “Për pensionet e punonjësve që kanë punuar në miniera, në nëntokë”, edhe puna e kryer gjatë gjithë ditës në nëntokë, në profesionet: mekanik, elektrikist dhe punonjës të tjerë të nëntokës në miniera dhe gjeologji.”.

2. Ngarkohet Instituti i Sigurimeve Shoqërore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 150/2014, “Për pensionet e punonjësve që kanë punuar në miniera, në nëntokë”.

KRYEMINISTRI
Edi Rama